



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 18.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.11.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Kosova Asfalt SHPK" për aktivitetin: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni-Lagja Vakoc" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1262-511 nxjerr:

VENDIM

APROVOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Kosova Asfalt SHPK" e datës 16.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i rruges nga Flotacioni-Lagja Vakoc" dhe me numër të prokurimit: 616 -29-1262-511" kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 11.11.2020*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. **Anulohet** *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 11.11.2020 dhe aktiviteti kthehet ne rivleresim;*
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Kosova Asfalt SHPK" me datë 16.11.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni-Lagja Vakoc" dhe me numër të prokurimit: 616 -29-1262-511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 18.11.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 72 te LPP-se eshte i bazuar, pasi qe lidhur me çertifikatat per latues dhe armirues ka mund te kerkohen sqarime, pasi qe ato kane qene te pa qarta dhe te pa afatshme. Pretendimi juaja se ato çertifikata jane dorezuar si deshmi e trajnimit per punetoret qe kane pase çertifikata dhe deshmi te meherhshme per profesionin e kerkuar mund te jete i sakte, por bazuar ne nenin 72 te LPP-se dhe ne nenin 39.8 te RRUOPP-se mbetet detyre e Autoritetit Kontraktues qe te kerkoj sqarime ne fazen e

rivleresimit te ketij aktiviteti.Se nje kerkese e tille per sqarime eshte dashte ti behet pretenduesit eshte rekomanduar edhe me Vendimin e OSHP-se numer 611-612/20. - Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pretenduesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

